



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 1128/2024

lidhur me çështjen e arsimimit cilësor – gjuha e shenjave për personat e shurdhër

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër në detyrë
Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Hajrullah Çeku, ministër në detyrë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Kopje:

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 24 korrik 2026

Qëllimi i raportit.

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në vijim: MASH) lidhur me avancimin e cilësisë në arsim - gjuhën e shenjave për personat e shurdhër, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësimeve në Qendrën Burimore “Nënë Tereza” në Prizren.

Baza ligjore

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”
4. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “Të hetojë ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit. (neni 16, paragrafi 1);
 - ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrës ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);
 - të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
 - të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit. (neni 18, par. 1, nën-paragrafi 5);
 - t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);
 - të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 7);
 - t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 9).”

Përmbledhje e fakteve

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 31 tetor 2024 hapi hetim sipas detyrës zyrtare lidhur me çështjen e arsimimit cilësor në gjuhën e shenjave.
6. Avokati i Popullit, më 29 tetor 2024, gjatë një takimi me Forumin e Shoqërisë Civile, është vënë në dijeni se shumica e personave të shurdhër, të cilët e përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë, nuk dinë shkrim-lexim, megjithëse diplomat e tyre pasqyrojnë përfundimin e shkollimit me nota të larta.
7. Po ashtu, pretendimi i lartpërmendur iu konfirmua edhe përfaqësueses së Avokatit të Popullit në një punëtori të mbajtur më 15 nëntor 2024, me temën *“Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara për të qenë pjesë e procesit të vendimmarrjes”*.
8. Më 12 dhjetor 2024, Avokati i Popullit iu drejtua asokohe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), tashmë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me kërkesë për informata nëse MASHTI hartoi kurrikula dhe masa të përshtatshme për përgatitjen arsimore të personave të shurdhër dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në Kosovë, si dhe nëse stafi arsimor i angazhuar në mësimdhënien e personave të shurdhër ishte mjaftueshëm i përgatitur për këtë qëllim.
9. Më 24 dhjetor 2024, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga MASHTI, në të cilën thuhet se fëmijët/nxënësit e shurdhër dhe me dëmtime në dëgjim, në Qendrën Burimore “Nënë Tereza” në Prizren, shkollohen sipas Kurrikulës Bërthamë, e cila modifikohet në Planin Individual të Arsimit dhe në programin *“Mësimdhënia në fusha të aktiviteteve”*.
10. Më tej, në përgjigje thuhet se mësimdhënia realizohet me ndihmën e interpretëve të gjuhës së shenjave dhe asistentëve në klasa, pasi fëmijët janë grup heterogjen dhe mësimdhënia realizohet sipas nevojave dhe potencialit të tyre.
11. Po ashtu, thuhet se në Qendrën Burimore janë të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar: edukimi në fëmijërinë e hershme - klasat 1–5 dhe 6–9, si dhe arsimi i mesëm profesional me dy profile: rrobaqepësi dhe kuzhinieri.
12. Ndërsa, në pyetjen për stafin arsimor të angazhuar për mësimdhënie, MASHTI njoftoi se në Qendrën Burimore mësimdhënësit kanë qenë pedagogë specialë (ish-defektologë/surdologë), mirëpo tashmë janë pensionuar, përveç një defektologe-surdologe, e cila ende punon. Më tej në përgjigje thuhet se, në mungesë të pedagogëve specialë, mësimdhënësit aktualë kanë përgatitje universitare nga Fakulteti i Edukimit - Drejtimi Fillor ose Pedagogji e Përgjithshme, si dhe ka mësimdhënëës lëndorë. Në këtë qendër ka psikolog, mirëpo mungojnë nga fusha e rehabilitimit, si: audiolog, logoped dhe punëtor social.
13. Për sa u përket konkurseve të shpallura nga MASHTI - Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta, si kriter potencohet njohja e gjuhës së shenjave, kriter i cili shpesh nuk përmbushet. Megjithatë, pas rekrutimit në punë, personeli fillon aftësimin për gjuhën e shenjave sipas niveleve, gjë që, sipas MASHTI-t, është obligative për mësimdhënësit dhe stafin tjetër.
14. Më 19 shkurt 2025, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takim me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës Burimore “Nënë Tereza”, me qëllim të diskutimit lidhur me

pretendimet se nxënësit që ndjekin shkollimin e mesëm të lartë nuk zotërojnë shkrim-lexim. Ai vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë. Më tej, ai njoftoi se në qendër janë të angazhuar dy interpretë të gjuhës së shenjave, të cilët, sipas tij, nuk janë të mjaftueshëm, ndërsa më herët kanë qenë të angazhuar gjashtë asistentë, kurse aktualisht kanë mbetur vetëm katër.

15. Gjatë takimit me drejtorin, edhe ai vetë konfirmoi se gjuha e shenjave është obligative dhe se të gjithë mësimdhënësit ndjekin kursin e gjuhës së shenjave. Po ashtu, ai njoftoi se edhe prindërit e nxënësve kanë të drejtë ta ndjekin kursin e gjuhës së shenjave pa pagesë.
16. Po ashtu, drejtori konfirmoi se ka mungesë të profesionistëve adekuatë, si logopedë, punëtorë socialë, defektologë dhe surdologë. Lidhur me këtë, ai njoftoi se parashtruan kërkesë në MASHTI dhe morën përgjigje, sipas së cilës, MASHTI nuk lejohet me ligj të punësojë persona me profesione të tilla.
17. Në fund, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u takuan me nxënësit dhe mësimdhënësit, të cilët njoftuan se nxënësit vlerësohen me nota bazuar në angazhimin e tyre dhe se notat janë mbi mesataren.
18. Më 26 shkurt 2025, Qendra Burimore iu drejtua MASHTI-t me kërkesë për rekrutimin e stafit dhe vazhdimin e kontratave të punës për punëtorët që u skadojnë kontratat gjatë vitit 2025.
19. Më 26 mars 2025, Qendra Burimore njoftoi përfaqësuesen e Avokatit të Popullit se nuk mori përgjigje nga MASHTI.
20. Më 16 qershor 2025, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan përsëri takim me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës Burimore “Nënë Tereza”. Gjatë takimit, ai njoftoi se ende nuk mori përgjigje nga MASHTI, duke shtuar se më 25 prill 2025 përsëriti kërkesën drejtuar MASHTI-t, por përsëri nuk mori përgjigje.
21. Më tej, lidhur me pyetjen rreth vlerësimit të personelit, ai njoftoi se vlerësimi bëhet çdo vit nga koordinatori i cilësisë dhe se ekzistojnë katër nivele: A1, A2, B1 dhe B2.
22. Më 2 shtator 2025, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit zhvilloi takim me udhëheqësen e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës në MASHTI, ku u diskutua lidhur me kërkesat e parashtruara nga Qendra Burimore. Ajo njoftoi se kërkesa u miratua pjesërisht, vetëm për vazhdimin e kontratave për tre instruktorë të gjuhës, të cilëve kontratat u janë vazhduar vetëm për një vit, për arsye se të tre instruktorët kanë vetëm shkollim të mesëm. Ndërsa, për sa i përket kërkesës për rekrutimin e punonjësve të tjerë, ajo njoftoi se procesi është në zhvillim dhe se pritet të hapen konkurse, pasi gjatë vitit 2025 MASHTI pati shumë konkurse dhe, për këtë arsye, u vonua procesi i rekrutimit në bazë të kërkesave të qendrës.
23. Më tej, lidhur me mungesën e kapaciteteve profesionale, si defektologë, logopedë, punëtorë socialë etj., meqë edhe nga Qendra u njoftua se kjo çështje është problematike, u pyet se si do të veprojë MASHTI për punësimin e tyre. Ajo njoftoi se bëhet fjalë për profile mjekësore, si p.sh. logopedë, dhe se, sipas saj, MASHTI nuk hap konkurse për profesione të tilla. Megjithatë, ajo njoftoi se është duke u formuar një ekip ndërinstitutional, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, për ofrimin e shërbimeve në komuna, përkatësisht në qendrat e mjekësisë familjare, siç janë shërbimet e logopedisë.

24. Gjatë këtij takimi, edhe vetë udhëheqësja e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës në MASHTI pohoi se dëgjoi se nxënësit që përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë nuk kanë njohuri në shkrim-lexim, ndonëse e përfundojnë shkollimin me nota të larta. E njëjta u zotua se, përmes postës elektronike, do të na i dërgojë notat mesatare të të gjithë nxënësve.
25. Për sa i përket vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, ajo njoftoi se vlerësimi është gjithmonë pozitiv. Edhe pse personeli i Qendrës e ka obligim ndjekjen e kursit të gjuhës së shenjave, ajo njoftoi se jo të gjithë mësimdhënësit i kanë përfunduar të gjitha nivelet dhe se shumica prej tyre kanë vetëm nivelin A1, ndërsa një numër shumë i vogël i mësimdhënësve ka arritur deri në nivelin e fundit.
26. Më 24 shtator 2025, udhëheqësja e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës, përmes postës elektronike, ia dërgoi përfaqësueses së Avokatit të Popullit listën e notës mesatare për të gjitha klasat në Qendrën Burimore “Nënë Tereza”. Bazuar në listën e dërguar, vërehet se, nga klasa parafillore deri në klasën e dymbëdhjetë, notat janë mbi mesatare, që nënkupton 3.35.
27. Më 26 maj 2026, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi udhëheqësen e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës në MASHT për sqarime lidhur me faktin se në ueb-faqen e MASHT-it rezulton se në vitet 2024 dhe 2025 u hapën konkurse për pozitën “Zyrtar i Lartë për Arsimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta”, ku ndër kriteret e kërkuara ka qenë edhe diploma baçelor në drejtimin e logopedisë. Ndërsa, në një takim të mëhershëm, ajo deklaroi se MASHT-i nuk hap konkurse për profile si logopedi, duke i konsideruar ato si profesione mjekësore. Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kërkoi sqarim se si MASHT-i hap konkurse në Divizionin për Arsim me Nevoja të Veçanta me këtë profil, por jo edhe në Qendrat Burimore. Udhëheqësja nuk dha përgjigje konkrete dhe udhëzoi që çështja t’i drejtohet Departamentit për Burime Njerëzore. Edhe pasi kontaktua këtë departament, nuk dha përgjigje konkrete, me arsyetimin se nuk është kompetent për këtë çështje.
28. Deri në momentin e publikimit të këtij raporti, MASHT-i nuk publikoi ndonjë konkurs për rekrutimin e personelit në Qendrën Burimore “Nënë Tereza”.
29. Më 25 qershor 2026, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit pritën në takim përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve (ShKSh) dhe kryetarin e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar (FKAK), me qëllim të diskutimit të çështjeve që lidhen me cilësinë e arsimit për personat e shurdhër. Gjatë takimit, përfaqësuesit e këtyre organizatave theksuan se personat e shurdhër përballen çdo ditë me sfida të shumta në realizimin e së drejtës për arsim dhe njoftuan se shqetësimet e tyre do t’ia paraqesin me shkrim Avokatit të Popullit.
30. Më 1 korrik 2026, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (ShKSh), përmes postës elektronike, i paraqiti Avokatit të Popullit një sërë shqetësimesh, duke përfshirë: mungesën e mësimdhënies përmes gjuhës së shenjave, në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar; mungesën e një dallimi të qartë ndërmjet rolit të interpretit të gjuhës së shenjave dhe rolit të mësimdhënësit në ofrimin e arsimit bilingual; mungesën e profileve profesionale mbështetëse për realizimin e së drejtës për arsim në gjuhën e shenjave; mungesën e përshtatjes së Kurrikulës Bërthamë dhe të qasjes pedagogjike për nxënësit që e përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të parë; si dhe mungesën e parashikimit të njohjes së gjuhës së shenjave si kriter për punësimin e mësimdhënësve.

31. Gjithashtu, u ngrit shqetësimi lidhur me mospërputhjen ndërmjet deklaratave të institucioneve përgjegjëse dhe gjetjeve të paraqitura në Studimin mbi nivelin e arritjeve akademike të nxënësve me dëmtime në dëgjim në Qendrën Burimore “Nënë Tereza” në Prizren, i cili është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtimi i kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës – INCLUDE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, në tetor 2023. Sipas këtij studimi: *“Testi i shkathtësive të leximit tregoi se asnjë nga 14 nxënësit e testuar nga klasa 4 deri në 12 nuk arrin të lexojë dhe kuptojë as edhe fjali të thjeshtë, dhe arsyt kryesore për këtë janë mungesa e gjuhës së shenjave dhe shkathtësive pedagogjike të mësimeve, mungesa e materialeve të përdorura në mësimdhënie, mungesa e angazhimit të përkthyesve të gjuhës së shenjave dhe mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.”*
32. Më tej, ShKSh-ja njoftoi se Ministria e Arsimit dhe Shkencës lidhi marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve, me qëllim të zhvillimit të arsimit për personat me dëmtime në dëgjim dhe forcimit të përdorimit të gjuhës së shenjave në sistemin arsimor. Sipas ShKSh-së, marrëveshja parasheh zhvillimin e standardeve profesionale, kurrikulave, programeve të trajnimit, materialeve mësimore dhe mekanizmave institucionalë për mbështetjen e arsimit bilingual. Në këtë kontekst, ShKSh-ja theksoi se, përmes kësaj marrëveshjeje, Ministria ka njohur nevojën për zhvillimin e këtyre mekanizmave si pjesë e përmbushjes së detyrimeve të saj në fushën e arsimit për personat e shurdhër.
33. Në fund, ShKSh-ja kërkoi referimin në Udhëzuesin për Arsimin Gjithëpërfshirës, Arsimin Dygjuhësh dhe Gjuhën e Shenjave (MASHTI, 2019), i cili, sipas ShKSh-së, paraqet dokumentin profesional që orienton zhvillimin e arsimit për nxënësit me dëmtime në dëgjim dhe promovon përdorimin e gjuhës së shenjave si gjuhë e parë e nxënësve të shurdhër.

Korniza ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës

34. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 47 [E Drejta për Arsimin], përcakton:

“1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.

2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

35. Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 3 [Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar], paragrafi 1, përcakton: *“Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim.”* Kurse në paragrafin 3 të po këtij neni përcakton: *“Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social arsimi është e drejtë themelore për çdo person dhe nuk mund t’i mohohet askujt.”*

36. Neni 40 [Parimi i arsimit gjithëpërfshirës], paragrafët 1, 2 dhe 3, përcakton:

“1. Qëllimi i qartë i këtij Ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, si parashihi në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve (1989), në Deklaratën e Salamankës (1994), Konventën e OKB-së për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) dhe në konventat apo rekomandimet e tjera përkatëse ndërkombëtare.

2. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës nënkupton se:

2.1. institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve;

2.2. mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve; dhe

2.3. ambientet e posaçme arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimit.

3. Komunitat marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkollat të rregullta të komunës, përfshirë edhe themelimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, përfshirë ato ndijore.”

Neni 43 [Gjuha e shenjave dhe sistemi Brejll (Braille)], paragrafët 1 dhe 2, përcakton:

1. Nxënësve dhe fëmijëve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t’u ofrohet mësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe përmes mënyrës së gjuhës së shenjave.

2. Ministria mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorimin e gjuhës së shenjave të ofrohet në një lokacion jashtë institucionit të zakonshëm të nxënësve.

37. Udhëzimi Administrativ nr. 05/2024 për Qendrat Burimore, në nenin 18, përcakton:

“Qendrat burimore kanë këtë strukturë të shërbimeve të mbështetjes strukturën e shërbimeve të mbështetjes: Ekipi mobil profesional; Pedagogu special; Psikologu shkollor; Punëtori social; Logopedi; Ekspert i fushës sipas specifikës.”

38. Rregullorja QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, neni 2, paragrafi 2, përcakton:

“Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal, janë të obliguara që personave nga komuniteti i të shurdhërve t’i ofrojnë shërbim sipas nevojës dhe kërkesave në gjuhën e shenjave obligon të gjitha institucionet publike në të dy nivelet që personave të shurdhër t’u ofrojnë shërbime sipas nevojës dhe kërkesës në gjuhën e shenjave.”

Analiza dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

39. Avokati i Popullit vlerëson se, duke u bazuar në kornizën ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, shteti ka detyrim pozitiv për të garantuar arsim cilësor, efektiv dhe të barabartë për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët e shurdhër dhe ata me dëmtime në dëgjim.

40. Megjithëse Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas Kushtetutës, nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës, ajo përmendet në Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (neni 40, paragrafi 1), rrjedhimisht shteti obligohet t'i zbatojë standardet e përcaktuara në këtë Konventë.
41. Një çështje tjetër që Avokati i Popullit vëren kur bëhet fjalë për personat e shurdhër, është se shpesh ngrihet pyetje nëse këta persona janë persona me aftësi të kufizuar apo jo. Sipas Konventës në fjalë, neni 1: *“Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërvëprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.”*
42. Dëmtimet shqisore janë gjendje që prekin një ose më shumë nga shqisat e një personi dhe mund të kufizojnë mënyrën se si ai merr ose përpunon informacionin nga mjedisi nëpërmjet shqisave. Në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe të aftësisë së kufizuar, ky term zakonisht i referohet dëmtimit të dëgjimit dhe dëmtimit të shikimit.
43. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit, duke iu referuar Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, konstaton se personat dhe fëmijët me dëmtime në dëgjim mbrohen nga standardet e përcaktuara në këtë Konventë.
44. Neni 24 [Arsimi], paragrafi 4, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara obligon shtetet të sigurojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të mundësojnë mësimdhënie në gjuhën dhe mënyrat më të përshtatshme të komunikimit për personat e shurdhër, si dhe të sigurojnë personel të trajnuar që njeh gjuhën e shenjave:
- “Me qëllim që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për punësimin e mësuesve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuar, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille, dhe të trainojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar.”*
45. Po ashtu, Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹ thekson se arsimi gjithëpërfshirës nuk realizohet vetëm nëpërmjet regjistrimit formal të nxënësve në shkollë, por përmes sigurimit të mbështetjes efektive dhe rezultateve reale në mësimnxënie.
46. Rrjedhimisht, e drejta në arsim nuk kufizohet vetëm në sigurimin e qasjes fizike në institucionet arsimore, por përfshin edhe detyrimin pozitiv të shtetit për të garantuar arsim cilësor për fëmijët dhe personat e shurdhër.
47. Në këtë drejtim, pretendimet se nxënësit e përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë pa njohuri funksionale në shkrim-lexim, megjithëse vlerësohen me nota të larta, tregojnë për mospërputhje ndërmjet suksesit formal dhe rezultateve reale.
48. Nga hetimet e zhvilluara rezulton se shumica e personelit arsimor nuk ka përgatitje specifike për arsimimin e fëmijëve të shurdhër, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre

¹ <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-4-article-24-right-inclusive>

posedon vetëm nivelin bazik (A1) të gjuhës së shenjave. Ky konstatim mbështetet edhe në Studimin mbi nivelin e arritjeve akademike të nxënësve me dëmtime në dëgjim në Qendrën Burimore “Nënë Tereza” në Prizren (shih pikën 31 më lart), i cili vë në pah se faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësinë e pamjaftueshme të arsimit të ofruar për personat e shurdhër dhe personat me vështirësi në dëgjim janë mungesat e shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve, mungesa e materialeve mësimore adekuate për mësimdhënie, mungesa e angazhimit të përkthyesve të gjuhës së shenjave, si dhe mungesa e gjuhës së shenjave si lëndë mësimore për nxënësit e shurdhër dhe nxënësit me vështirësi në dëgjim.

49. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se dispozita e nenit 43 të Ligjit nr. 04/L-032 përcakton një detyrim të qartë për institucionet përgjegjëse që të sigurojnë realizimin efektiv të së drejtës së nxënësve që përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të parë, për të marrë mësimdhënie përmes kësaj gjuhe. Përmbushja e këtij detyrimi kërkon krijimin e kushteve të nevojshme profesionale, pedagogjike dhe institucionale, përfshirë përgatitjen dhe angazhimin e mësimdhënësve.
50. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e stafit të specializuar në fusha specifike, si logopedë, surdologë, audiologë, defektologë dhe punëtorë socialë; mungesa e interpretuesve të gjuhës së shenjave dhe asistentëve; mungesa e mekanizmave efektivë për vlerësimin real të arritjeve akademike të nxënësve; si dhe mosreagimi adekuat ndaj kërkesave të vazhdueshme të Qendrës Burimore, vënë në pikëpyetje përmbushjen e standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare për një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.
51. Këto rrethana paraqesin rrezik serioz për diskriminim ndaj fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim dhe cenim të së drejtës së tyre për zhvillim të plotë dhe integrim të barabartë në shoqëri.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

52. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në rastin *G.L kundër Italisë* (nr. 59751/15, 10 shtator 2020), gjeti shkelje të nenit 14 të KEDNj-së në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1.²

Parashtruesja, e lindur në vitin 2004, e cila vuante nga autizmi joverbal, nuk kishte mundur të përfitonte, gjatë dy viteve të para të shkollimit fillor, nga viti 2010 deri në vitin 2012, asistencën e specializuar të garantuar sipas legjislacionit përkatës. Për këtë arsye, ajo ishte detyruar të siguronte asistencë private të specializuar, duke i mbuluar vetë shpenzimet për këtë shërbim. Ajo pretendonte se shteti kishte dështuar në përmbushjen e detyrimit të tij pozitiv për të garantuar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

GjEDNj-ja konsideroi se thelbi i ankesës së parashtrueses lidhej me pretendimin se ajo kishte pësuar trajtim diskriminues. GjEDNj-ja theksoi se: shtetet kanë detyrimin të sigurojnë akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara; se mungesa e burimeve financiare nuk mund të justifikojë automatikisht mosofrimin e mbështetjes së parashikuar me ligj; dhe se autoritetet italiane nuk kishin vlerësuar nevojat konkrete të vajzës dhe nuk kishin marrë masat e nevojshme për t'i garantuar asaj mundësi reale për të ndjekur arsimin në kushte të barabarta me fëmijët e tjerë.

² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/ecthr-fra-2025-reasonable-accomodation_en.pdf fq. 13/17

Rrjedhimisht, GjEDNj-ja konstatoi shkelje të nenit 14 të Konventës, në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1, pasi autoritetet nuk i siguruan fëmijës me autizëm mbështetjen e specializuar në shkollë, të parashikuar me ligj, gjë që përbënte diskriminim në ushtrimin e së drejtës për arsim.

Duke u bazuar në të cekurat më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit: “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”; dhe me nenin 16, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit “[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...]”, si dhe “të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (neni 16, paragrafi 1.6). Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministritë së Arsimit dhe Shkencës:

1. Të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin efektiv të nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.
2. Të sigurojë angazhimin e stafit të specializuar shumëdisiplinar (logopedë, surdologë, audiologë, defektologë dhe punëtorë socialë) në Qendrën Burimore “Nënë Tereza”, si kriter i detyrueshëm ligjor.
3. Të sigurojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, edukatorëve, instruktorëve të gjuhës së shenjave, interpretëve të gjuhës së shenjave dhe profesionistëve të tjerë mbështetës që punojnë me nxënësit me dëmtime në dëgjim.
4. Të zhvillojë inspektime të rregullta në institucionet arsimore me qëllim të verifikimit të cilësisë së arsimit që ofrohet në Qendrën Burimore “Nëna Tereza”.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjia duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit